



FLETORJA ZYRTARE

E REPUBLIKËS SË

SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 234

Tiranë – E mërkurë, 30 dhjetor 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1100, datë 28.12.2015	Për miratimin e buxhetit të vitit 2016 për Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme..... 16143
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1102, datë 28.12.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 682, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”..... 16145
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1106, datë 29.12.2015	Për shpërblimin e punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë..... 16146
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 48, datë 28.12.2015	Për shpërndarjen e financimit për disa projekte të programit të arsimit, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, si dhe për disa ndryshime në vendimin nr. 41, datë 16.10.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve..... 16146
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 95, datë 16.12.2015	Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë shtesë nga Banka NBG Albania sh.a..... 16149
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 96, datë 16.12.2015	Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë shtesë nga Banka Alpha Albania sh.a..... 16149
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 150, datë 11.12.2015	Për fillimin e procedurave për miratimin e “Metodologjisë së përcaktimit të tarifës fikse të energjisë elektrike të prodhuar nga centralet me përparësi që shfrytëzojnë burime të rinovueshme energjie”..... 16150
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 151, datë 11.12.2015	Mbi fillimin e procedurave për miratimin e rregullores së procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. te shoqëritë e licencuara për tregtimin e energjisë elektrike..... 16150

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 152, datë 11.12.2015	Mbi fillimin e procedurave për miratimin e rregullores për vendosjen e gjobave dhe kushtet e lehtësimit prej tyre.....	16150
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 153, datë 11.12.2015	Mbi operimin në treg të prodhuesve me kapacitet të instaluar nën 1 MW dhe vetëprodhuesve të energjisë elektrike.....	16151
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 154, datë 11.12.2015	Mbi miratimin e rregullave për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.....	16151
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 6518/3, datë 22.12.2015	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i projektit “Ndërtimi i rrugës paralel me murin rrethues të Portit Detar Durrës”.....	16152



VENDIM

Nr. 1100, datë 28.12.2015

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË
VITIT 2016 PËR ZYRËN E
REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “b”, të nenit 13, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe të nenit 29, të ligjit nr. 9936/2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e programit të Shërbimit të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për vitin 2016, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Miratimin e buxhetit për programin e Shërbimit të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për vitin 2016, sipas tabelave nr. 2 dhe nr. 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohet Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA 1

PEMA E PROGRAMIT TE ZRPP PER VITIN 2016

Qëllimi i Politikës së Programit

Qëllimi kryesor i Politikës së Institucionit konsiston në përmirësimin e dhënies së shërbimeve nepermjet përfundimit të procesit të regjistrimit fillestar në të gjithë vendin, si dhe modernizimit të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, me qëllim automatizimin e shërbimeve, përditesimin e të dhënave dixhitale të karteles dhe hartës treguese të regjistrimit, duke garantuar informacionin e regjistruar mbi të gjitha pasuritë e paluajtshme në Shqipëri, nëpërmjet një sistemi të sigurt, efikas, bashkëkohor të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme.


OBJEKTIVAT**OBJEKTIVI 1:** Regjistrimi Fillestar i Pasurive të Paluajtshme**OBJEKTIVI 2:** Automatizimi i sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme;**OBJEKTIVI 3:** Ndertimi i infrastruktures se ZRPP nrm kompletimit te zrpp me pajisje elektronike, orendi, dhe rikonstruksionit te ambjenteve te ZVRPP



Tabela nr. 2

Ne 000/ leke

BUXHETI 2016		
Pershkrimi	Buxheti 2015	
	Te Ardhura	Shpenzime
	(1)	(2)
Te ardhura nga Sherbimet	1,550,000	
Shpenzime personeli		710,000
Shpenzime korente		336,900
Investime		503,100
Fondi rezerve		0
Total	1,550,000	1,550,000
Teprica (1)-(2)		0
Investime te pambuluara nga te ardhurat e planifikuara te ZRPP per vitin 2016		833,048

Tabela nr.3

BUXHETI I VITIT 2016

Ne 000/leke

Nr.	EMERTIMI	BUXHETI 2016
I	TOTALI I TE ARDHURAVE	1.550.000
1	Te ardhura jotatimore	1.550.000
	Te ardhura nga tarifat e Sherbimeve	1.550.000
II	TOTALI I SHPENZIMEVE	1.550.000
1	Shpenzime personeli	710.000
	Paga	584.000
	Kontribute per Sigurime Shoqerore	96.900
	Fondi i vecante i pagave	29.100
2	Shpenzime operative	336.900
	Shpenzime te mirembajtjes e te tjera	336.900
3	Shpenzime Kapitale nga te cilat	503.100
	Investime kapitale te brendshme	503.100
4	Fondi Rezerve	0
	Fondi Rezerve	0
	TE ARDHURA (-) SHPENZIME	0
III	Projekte qe nuk arrijne te mbuloohen me te ardhurat e planifikuara ZRPP per vitin 2016	
1	Projekti 1. Ndërtimi i Sistemit Multifunksional për shërbimet që ofrohen në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	355.140
2	Projekti 2. Përmirësimi i shërbimit të dhenash dhe Regjistrimit fillestar	477.908

Nr	Pershkrimi	Vlera ne 000/leke
1	Projekti 1. Ndërtimi i Sistemit Multifunksional për shërbimet që ofrohen në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	355.140
2	Projekti 2. Përmirësimi i shërbimit të dhenash dhe Regjistrimit fillestar	477.908
3	Shpenzime Page (per 150 punonjes)	136.800
4	Sigurime shoqerore (per 150 punonjes)	22.846
5	Shpenzime korente	41.625
6	Infrastruktura e projektit (Paisje elektronike, orendi, qera ambjentesh, Afishim, kartelash)	276.637
	Total	833.048

ZRPP, krahas objektivave te tjera te percaktuara ne Buxhetin e ZRPP per vitin 2016, ka si qellim realizimin e projekteve te meposhtme: 1)Ndërtimin e Sistemit Multifunksional për shërbimet që ofrohen në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme 2) Përmirësimi i shërbimit të dhenash dhe Regjistrimit fillestar. Per realizimin e ketyre 2 projekteve nevojitet nje fond ne total prej 833.048 mije lekesh icili sipas projekteve eshte i ndare si me siper. Vlere kjo, te cilen me te ardhurat qe ZRPP ka parashikuar te realizojte gjate vitit 2016, nuk arrin ta mbuloje. Per mbulimin e ketyre shpenzimeve, kerkohen menyra te tjera financimi.



VENDIM

Nr. 1102, datë 28.12.2015

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 682, DATË 29.7.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRDORIMIN E FONDEVE PUBLIKE
PËR TRANSPORTIMIN E PUNONJËSVE
ARSIMORË QË PUNOJNË DHE TË
NXËNËSVE QË MËSOJNË JASHTË
VENDBANIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 6, 19 e 28, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, nenit 11, të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, kreut II, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportin rrugor”, të ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 682, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Shkronja “a”, e pikës 1 të vendimit, ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“a) punonjësve mësimorë të arsimit parauniversitar, ku përfshihen punonjësit e arsimit parashkollor, arsimit fillor, arsimit të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë (drejtor, nëndrejtor, mësues, edukator), të institucioneve arsimore publike që punojnë jashtë qendrave urbane, qytetit/fshatit, në largësinë mbi 5 km nga kufiri i njësive përbërëse administrative të vendbanimit të tyre të përhershëm dhe kthehen brenda ditës në vendbanim;”.

2. Pika 2 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“2. Njësitë e qeverisjes vendore, mbështetur në numrin e punonjësve arsimorë dhe nxënësve që planifikohen të përfitojnë nga shërbimi i transportit, në bashkëpunim me njësitë arsimore vendore përkatëse, miratojnë hartën e linjave, sipas largësive të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi.”.

3. Pika 3 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“3. Njësitë e qeverisjes vendore, mbështetur në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, prokurojnë fondet publike për shërbimin e transportit të nxënësve dhe punonjësve arsimorë, sipas linjave rrethqytetëse të shërbimit të transportit publik, të licencuara në bazë qarku nga njësitë e qeverisjes vendore ose qendrore.”.

4. Pika 4 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“4. Në rastet kur njësitë e qeverisjes vendore nuk realizojnë me sukses procedurat e prokurimit publik të shërbimit të transportit të punonjësve arsimorë dhe nxënësve, të parashikuara në pikën 3, të këtij vendimi, realizojnë mbulimin e shpenzimeve për shërbimin e transportit të punonjësve arsimorë dhe nxënësve përfutues drejtpërdrejt, nëpërmjet llogarive bankare, në bankat e nivelit të dytë ose pranë zyrave të Postës Shqiptare, në përputhje me pikën 4, të këtij vendimi.

Masa e shpenzimeve përlogarit mbi bazën e numrit të nxënësve dhe mësuesve, numrit të ditëve mësimore, çmimit mesatar të biletës për linjat ndërqytetëse apo rrethqytetëse të shërbimit të transportit, të miratuara me vendimin nr. 146, datë 26.2.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”, të ndryshuar, dhe të indeksimit të çmimeve të shërbimit të transportit, të botuara çdo vit nga INSTAT-i, si dhe në bazë të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Specifikisht, për periudhën nga 1 janari 2016 e deri në realizimin me sukses të procedurave të prokurimit, njësitë e qeverisjes vendore kryejnë mbulimin e shpenzimeve për shërbimin e transportit, sipas procedurës së parashikuar në paragrafin e parë, të pikës 4, të këtij vendimi.”.

5. Pika 5 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“5. Punonjësit arsimorë, që përfitojnë transport sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij vendimi, bazuar në vendimin nr. 194, datë 22.4.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve arsimorë në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar:

a) nuk përfitojnë shpërblim mujor, kur largësia nga vendbanimi i përhershëm i tyre është deri në 10 km;



b) përfitojnë shpërblim 1 000 (një mijë) lekë në muaj, kur largësia është mbi 10 km, deri në 20 km;

c) përfitojnë shpërblim 1 800 (një mijë e tetëqind) lekë në muaj, kur largësia është mbi 20 km.”.

6. Pas pikës 5 shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5/1.Njësitë arsimore vendore dhe njësitë e qeverisjes vendore bashkëpunojnë dhe koordinojnë të dhënat për numrin e përfituesve dhe largësitë nga vendbanimi dhe raportojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në mënyrë periodike, çdo tre muaj, sipas udhëzimeve të ministrit përgjegjës për arsimin dhe sportin.”.

7. Pika 6 ndryshon, me këtë përmbajtje:

“6. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i përvitshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, e cila transferon fondet përkatëse të njësitë e qeverisjes vendore, dhe nga buxheti i vetë njësisë së qeverisjes vendore, në rastet kur tejkalohej numri i përfituesve, sipas pikës 5/1, të këtij vendimi.”.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet financiare nga data 1 janar 2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 1106, datë 29.12.2015

PËR SHPËRBLIMIN E PUNONJËSVE TË GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 35, të ligjit nr. 8869, datë 22.5.2003, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin e punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë, në vlerën 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë.

2. Efekti financiar për përballimin e këtij shpenzimi të mbulohet nga fondi i pagave, i

planifikuar për vitin 2015, për programin buxhetor “Garda e Republikës”.

3. Masa e shpërblimit të jetë deri në 1 (një) pagë mujore.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 48, datë 28.12.2015

PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR DISA PROJEKTE TË PROGRAMIT TË ARSIMIT, PJESË E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE, SI DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 41, DATË 16.10.2015, TË KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve për disa projekte në vazhdim, me cikël financimi 2012-2013, për programin e arsimit, specifikuar sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhej vendimit nr. 41, datë 16.10.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e fondit për arsimin, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, si dhe për disa ndryshime në vendimin nr. 11, datë 25.2.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve”, bëhen ndryshime, sipas tabelës 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Të gjitha autoritetet kontraktuese, me projekte të financuara sipas pikës 2, të këtij vendimi, duhet të paraqesin, rregullisht, pranë sekretariatit teknik, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, informacion për ecurinë financiare të disbursimeve të projekteve, të shoqëruar me dokumentet përkatëse.

4. Ngarkohet sekretariati teknik pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të kryejë



monitorimin dhe raportimin e ecurisë së zbatimit të projekteve pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, sipas dokumenteve të paraqitura nga autoritetet kontraktuese, sipas pikës 3, të këtij vendimi.

5. Ngarkohen ministri i Arsimit dhe Sportit, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar.

Tabela 1. Projektet në vazhdim, program i Arsimit, me cikël financimi 2012-2013

Nr.	Ish-Autoriteti Kontraktues	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e kontratës (në Lekë)	Vlera e disbursuar për vitin 2014 (në Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në Lekë)	Vlera shtese e financimit për vitin 2015 (në Lekë)	Vlera e mbetur e financimit për vitin 2016 (në Lekë)
1	Komuna Fajze	Bashkia Has	Rikonstruksion shtesë shkolle Vranisht, Komuna Fajze	47,923,053	42,413,690	2,500,000	3,009,363	0
2	Komuna Fushe Kuqe	Bashkia Lac	Ndërtim i shkollës 9-vjecare, fshati Adriatik, komuna Fushe Kuqe	39,964,732	13,204,602	12,189,968	14,570,162	0
3	Komuna Katund I Ri	Bashkia Durrës	Ndërtim shkolla 9-vjeçarë, Fshati Sukth, Komuna Katund I Ri	83,847,168	42,967,567	13,000,000	27,879,601	0
4	Komuna Shkrel	Bashkia Puke	Rikonstruksion shkolla 9-vjecare, Vrrithe, Komuna Shkrel	14,551,721	7,501,200	0	7,050,521	0
6	Komuna Mollas Elbasan	Bashkia Elbasan	Ndërtim shkolla e mesme "Osman Gjini", Komuna Mollas Elbasan	166,525,202	149,672,897	8,000,000	8,852,305	0
7	Komuna Bradashesh	Bashkia Elbasan	Ndërtim shkolla e mesme Bradashesh	164,370,151	90,000,000	35,000,000	39,370,151	0
8	Komuna Proptisht	Bashkia Pogradec	Ndërtim i ri shkolla e mesme e bashkuar Radokal	49,418,641	39,418,641	3,999,999	6,000,001	0
9	Komuna Tërbuf	Bashkia Divjake	Rikonstruksion dhe shtesë e shkollës së mesme të bashkuar Cerme Sektor, Tërbuf, Komuna	60,047,363	26,047,363	4,800,000	29,200,000	0
10	Bashkia Kukës	Bashkia Kukës	Rikonstruksion i shkollës Havzi Nela, Kukës	22,000,000	5,000,000	0	17,000,000	0
11	Komuna Synej	Bashkia Kavaje	Ndërtim shkolla 9-vjeçare dhe e mesme "11 Shkurti" Komuna Synej, Kavaje	53,849,928	43,270,991	4,200,000	6,378,937	0
12	Komuna Xhafzotaj	Bashkia Durrës	Ndërtim i shkollës 9-vjeçare në fshatin Rreth, Komuna Xhafzotaj	72,000,000	59,395,000	4,000,000	8,605,000	0
13	Komuna Kashar	Bashkia Tirane	Palestër dhe ngrohje, sistemim shkolla e mesme Katund Ri,	34,270,193	27,174,721	0	7,095,472	0
14	Komuna Qafe Mali	Bashkia Puke	Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare Kryezi, Komuna Qafe Mali, Puke	14,561,026	5,491,435	5,000,000	4,069,591	0
15	Komuna Lopez	Bashkia Tepelene	Rikonstr shkolla 9-vjeçare Sinanaj, Komuna Lopez, Tepelene	46,180,118	21,180,458	15,312,460	9,687,200	0
16	Komuna	Bashkia	Rikonstruksion shkolla	47,518,206	16,638,462	10,880,000	19,999,744	0



	Bubullime	Lushnje	e mesme e bashkuar "DH.Mino", Komuna Bubullime					
17	Universiteti "Aleksander Moisiu", Durres	Universiteti "Aleksander Moisiu", Durres	Ndërtimi i nje godine te re universitare per Universitetin "Aleksander Moisiu" Durres (detyrim)	255,000,000	124,488,651	21,202,000	18,528,020	90,781,329
18	Universiteti Politeknik, Tirane	Universiteti Politeknik, Tirane	Ndërtim, Shtesa e godinës së Universitetit Politeknik Tiranë (detyrim)	128,041,000	50,000,000	21,071,000	15,000,000	41,970,000
			TOTALI	1,300,068,502	763,865,678	161,155,427	242,296,068	132,751,329

Shënim:

1. "Ish autoriteti kontraktues", përfaqëson autoritetin kontraktues "komunat", të cilësuar "njësi që shkrihen", nga reforma territoriale-administrative, e vitit 2015.
2. "Autoriteti kontraktues", përfaqëson autoritetin e ri kontraktues "bashkia", të cilit i kanë kaluar të gjitha të drejtave dhe detyrimet e kontratave, të "njësive që shkrihen".
3. "Vlera e kontratës" përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, të kërkuar për financim nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve. Vlera e kontratës përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit).
4. "Vlera e disbursuar për vitin 2014" tregon vlerën e disbursimit për vitin 2014, sipas Ministrisë së Financave.
5. "Vlera e financimit për vitin 2015" tregon vlerën e financimit që u vu në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, që miratuan financimin e objektit.
6. "Vlera shtesë e financimit për vitin 2015" tregon vlerën e shtuar mbi vlerën e financimit që u vu në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, që miratuan financimin e objektit.
7. "Vlera e mbetur e financimit për vitin 2016", tregon vlerën e mbetur të financimit, pas diferencës midis vlerës së kontratës, vlerës së disbursuar për vitin 2014, vlerën e financimit për vitin 2015 dhe vlerën shtesë të financimit" për vitin 2015.

Tabela 2. Ndryshim në vendimin nr. 41, datë 16.10.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve

Projektit nr.1, nr.2, nr.3 dhe nr.4, në tabelën 1 të këtij vendimi i reduktohet vlera e financimit për vitin 2015, si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emri i projektit	Vlera e projektit (Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)	Fonde që i reduktohen financimit të vitit 2015 (Lekë)
		QARKU VLORE			
1	Bashkia Sarandë	Ndërtimi EKO Kampus, Sarandë	347,771,215	34,777,122	34,777,122
		QARKU TIRANË			
2	Bashkia Tirane	Rikualifikim i terrenit sportiv në shkollën "Petro Nini Luarasi"	25,000,000	10,000,000	10,000,000
3	Bashkia Tirane	Rikonstrukcion i shkollës "Jordan Misja"	84,746,629	10,000,000	10,000,000
		QARKU Durrës			
4	Bashkia Durrës	Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare, "Bajram Curri"	119,376,062	30,000,000	30,000,000
		TOTALI	576,893,906	84,777,122	84,777,122

Shënim:

Me propozim të ministrit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, fondi i Programit të Arsimit, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015, për financimin e zbatimit të investimeve të vetë ministrisë, reduktohet në vlerën 29,725,461 Lekë.

**VENDIM****Nr. 95, datë 16.12.2015****PËR DHËNIEN E MIRATIMIT
PARAPRAK PËR KRYERJEN E
VEPRIMTARISË SHITESË NGA BANKA
NBG ALBANIA SHA**

Në bazë të nenit 12, shkronja “a”, nenit 43, shkronja “e”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 23, pikat 1 dhe 3, nenit 24, pika 1, shkronja “ç”, dhe nenit 54, pika 2, shkronja “dh”, nënpika “v”, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 11.3.2009, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraparak për kryerjen nga Banka NBG Albania sh.a., të veprimtarisë financiare shtesë, si më poshtë:

- tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetorganizuar (OTC) ose ndryshe të letrave me vlerë të transferueshme.

2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë të bëjë ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Bankës NBG Albania sh.a., në zbatim të pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Gent Sejko**

VENDIM**Nr. 96, datë 16.12.2015****PËR DHËNIEN E MIRATIMIT
PARAPRAK PËR KRYERJEN E
VEPRIMTARISË SHITESË NGA BANKA
ALPHA ALBANIA SHA**

Në bazë të nenit 12, shkronja “a”, nenit 43, shkronja “e”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 23, pikat 1 dhe 3, nenit 24, pika 1, shkronja “ç”, dhe nenit 54, pika 2, shkronja “dh”, nënpika “v”, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 11.3.2009, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraparak për kryerjen nga Banka Alpha Albania sh.a., të veprimtarisë financiare shtesë, si më poshtë:

- tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetorganizuar ose ndryshe të letrave me vlerë të transferueshme.

2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë të bëjë ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Bankës Alpha Albania sh.a., në zbatim të pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Gent Sejko**

**VENDIM****Nr. 150, datë 11.12.2015****PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
MIRATIMIN E “METODOLOGJISË SË
PËRCAKTIMIT TË TARIFËS FIKSE TË
ENERGJISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR
NGA CENTRALET ME PËRPARËSI QË
SHFRYTËZOJNË BURIME TË
RINOVUESHME ENERGJIE”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 15, pika 1, të ligjit nr. 138/2013, “Për burimet e energjisë së rinovueshme”, dhe nenit 25 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.12.2015, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të saj, dhe draftin për metodologjinë e përcaktimit të tarifës fikse të energjisë elektrike të prodhuar nga centralet me përparësi që shfrytëzojnë burime të rinovueshme energjie”,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e “Metodologjisë së përcaktimit të tarifës fikse të energjisë elektrike të prodhuar nga centralet me përparësi që shfrytëzojnë burime të rinovueshme energjie”.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve të interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti

VENDIM**Nr. 151, datë 11.12.2015****MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË
PROCEDURAVE TË BLERJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
SHOQËRIA OSHEE SHA TE SHOQËRITË
E LICENCUARA PËR TREGTIMIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 19; 69, germa “ë”, të ligjit nr. 43/2015, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 25 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me Faqe| 16150

vendimin e Bordit të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.12.2015, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit dhe drejtorive teknike të ERE-s, në lidhje me “Miratimin e rregullores së procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. te shoqëritë e licencuara për tregtimin e energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Mbështetur në nenin 69, germa “ë”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, OSHEE sh.a. ka detyrimin të draftojë dhe të dërgojë për miratim në ERE, rregulloren “Për procedurat e blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. te shoqëritë e licencuara për tregtimin e energjisë elektrike”.

- Rregullorja është hartuar në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, modelit të tregut të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008 dhe “Rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 68, datë 23.6.2008, i rishikuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e “Rregullores së procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. te shoqëritë e licencuara për tregtimin e energjisë elektrike”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti

VENDIM**Nr. 152, datë 11.12.2015****MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR
VENDOSJEN E GJOBAVE DHE
KUSHTET E LEHTËSIMIT PREJ TYRE**

Në mbështetje të neneve 106/2 dhe 107, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave



Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 25 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.12.2015, pasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe relacionin përkatës,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e draftit rregullores për vendosjen e gjobave dhe kushtet e lehtësimit prej tyre.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s

Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 153, datë 11.12.2015

MBI OPERIMIN NË TREG TË PRODHUESVE ME KAPACITET TË INSTALUAR NËN 1 MW DHE VETËPRODHUESVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në bazë të neneve 16; 18; 20, germa “a”; 37, pika 6, germa “b”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 10, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.2008, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 23, pika 4, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendim nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.12.2015, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike, në lidhje me operimin në treg të prodhuesve kapacitet të instaluar deri në 1 MW,

konstatoi se:

1. ERE merr vendime të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë të licencuarit që veprojnë në sektorin e energjisë elektrike (neni 20, germa “a”, i ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”).

2. ERE, ndër objektivat e saj, ka krijimin e kushteve lehtësuese për futjen në rrjet të kapaciteteve të reja prodhuese, si dhe heqjen e barrierave që mund të pengojnë futjen e

pjesëmarrësve të rinj të tregut (neni 18, pika “b”, e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”).

3. Çdo shoqëri tregtare që dëshiron të ushtrojë aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike me kapacitet të instaluar deri në 1 MW, mund ta bëjë atë pa miratimin e ERE-s (neni 37, pika 6, germa “b”, i ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”).

4. Administrata publike, në ushtrimin e funksioneve të saj, mbron në çdo rast interesin publik, si dhe të drejtat dhe interesat kushtetuese e ligjore të personave privatë (neni 10 i ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”).

VENDOSI:

1. Vetëprodhuesit, të cilët nuk janë të lidhur me rrjetin kombëtar ose kur lidhen në rrjetin kombëtar për qëllime të mirëmbajtjes së njësisë së prodhimit, nuk pajisen me licencë nga ERE.

2. Prodhuesit, përfshirë dhe vetëprodhuesit e energjisë elektrike të lidhur në rrjetin kombëtar, me kapacitet të instaluar deri në 1 MW, nuk pajisen me licencë nga ERE.

3. Kategoritë e prodhuesve dhe të vetëprodhuesve të parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, kanë detyrimin të njoftojnë ERE-n, në çdo rast që fillojnë të ushtrojnë veprimtari në tregun e energjisë elektrike.

4. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të licencuarit KESH sh.a., OST sh.a. dhe OSHEE sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s

Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 154, datë 11.12.2015

MBI MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR CERTIFIKIMIN E OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 58, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 26 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të



Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.12.2015, pasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga grupi i punës të rregullave për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike dhe relacionin përkatës,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Nr. 6518/3, datë 22.12.2015

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i projektit “Ndërtimi i rrugës paralel me murin rrethues të Portit Detar Durrës”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Durrës.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim.

Vlera totale e shpronësimit është 256,485,499 (dyqind e pesëdhjetë e gjashtë milionë e katërqind e tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I ZHVILLIMIT
URBAN
Gjon Radovani



TABELA E SHPRONESIMIT TE PASURIVE PTIVATE QE PREKEN NGA NDERTIMI I RRUGES PARALELE ME MURIN E PORTIT

Nr.	Nr. Pasurise	Pronari	Siperfaqja m2	Cmimi/m2 sipas VKM-se nr.514, date 30.7.2014	Vlera e truallit
1	6/58	Ilirjan Ferri	798.1	17,898	14,284,393.8
2	6/19	Satber Pilinku etj (konfirmuar per mbivendosje)	2458.5	17,898	44,002,233
3	6/25	Pelingu-Bilali etj(konfirmuar per mbivendosje)	464.1	17,898	8,306,461.8
4	6/42	Fatmir Alica et (konfirmuar per mbivendosje)	386.3	17,898	6,913,997.4
5	6/53	Lulzim Kelmendi	251.2	17,898	4,495,977.6
6	4/488	Henri Ylli Bekteshi	166.5	17,898	2,980,017.0
7	4/33	Kujtim Xhafa, Eni Xhafa, (konfirmuar per mbivendosje)	41.4	17,898	740,977.2
8	4/233	Elton Dudi	600	17,898	10,738,800.0
9	4/229	Elisabeta Kokomani etj	461.5	17,898	8,259,927.0
10	4/228	Ardian Lloshi, Ilir Vogli	998.7	17,898	17,874,732.6
11	4/376	Aferdita Rama, etj	194.4	17,898	3,479,371.2
12	4/196	Abaz Rubiku, etj	308.9	17,898	5,528,692.2
13	4/225	Naile Xhaferri etj	973.4	17,898	17,421,913.2
14	4/487	Bubullime Begteshi, etj	1275.6	17,898	22,830,688.8
15	4/223	Elsa Hila Ekonomi	1098.3	17,898	19,657,373.4
16	4/227	Harallamb Prifti	631.8	17,898	11,307,956.4
17	4/238	Enver Shaba	597.3	17,898	10,690,475.4
18	4/237	Kimete Kaziu (Mbivendosje me 4/417)	328.9	17,898	5,886,652.2
19	4/235	Shoqeria Gjyzeli BLB sha	627.8	17,898	11,236,364.4
20	4/255	Ikbali Katroshti	541	17,898	9,682,818.0
21	4/256	Arjan Katrgjini	309.1	17,898	5,532,271.8
22	4/234	Lush Mbrevataj, Yrben Cekolli	739.9	17,898	13,242,730.2
23	4/542	Kastrati shpk	77.7	17,898	1,390,674.6
	Shuma				256,485,499.2

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 113 lekë